



Roli i arsimit në zhvillimin ekonomik të vendit

Anemonë Zeneli

Gusht, 2013

Arsimi është një ndër shtyllat kryesore të një shoqërie të shëndoshë dhe të zhvilluar. Në mënyrë që një shtet të zhvillohet në shumë dimensione, duke pasur në fokus më së shumti ekonominë, duhet kushtuar rëndësi të veçantë sistemit arsimor. Arsimi nuk ka të bëjë vetëm me të mësuarit dhe marrjen e notave të mira, por është shumë më shumë se kaq. Çka në të vërtetë ngërthen në vete është njoftimi me fenomene të reja për të cilat nuk dimë shumë dhe ka për qëllim zgjerimin e dijes sonë. Një person i arsimuar di të dallojë të drejtën nga e gabuara e të keqen nga e mira.¹ Ata të cilët do të mësojnë se si të shkruajnë e të lexojnë do t'i sigurojnë një të ardhme më të mirë familjeve dhe shtetit të tyre. Thënë shkurt, arsimi ka fuqinë që ta bëjë botën një vend më të mirë.² Sado që vlera e arsimit cilësohet e madhe dhe e rëndësishme, nuk është se përparësitë dhe rezultatet pozitive të tij i kemi plotësisht të qarta. Çdo vit shkolle rrit mesataren vjetore të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) prej 0.37 %.³ Çdo vit shkolle rrit të ardhurat për person për 10 %.⁴ Po qe se te gjithë nxënësit e vendeve me të ardhura të ulëta do ta braktisnin shkollën me njohuri themelore të leximit, 171 milion njerëz do të nxirreshin nga varfëria e skajshme (ky 171 milionësh thënë ndryshe është i barabartë me numrin e popullsisë të këtyre vendeve: Australia 20.6 milionë, Kambodia 14.8 milionë, Kanada 33 milionë, Kolumbia 45.3 milionë, Holanda 16.6 milionë, Tunisia 10.4 milionë, Uganda 30.9 milionë) Kjo do të ndikonte në uljen e varfërisë globale për 12 %.⁵

Nga pikëvështrimi teorik, janë të paktën tre mekanizma përmes të cilëve arsimi mund të ndikojë në rritje ekonomike. Fillimisht, në perspektivën mikro, arsimi rrit kapitalin njerëzor të qenësishëm në fuqinë punëtore, e cila rrit produktivitetin e punës dhe kështu do të ketë rritje ekonomike në mënyrë të vazhdueshme drejt një niveli më të lartë të ekuilibrit të prodhimit. Së dyti, arsimi mund të rrisë kapacitetin inovativ të ekonomisë, si dhe njohuritë e reja për teknologjinë, produktet dhe proceset e reja që nxisin rritje. Së treti, arsimi mund të lehtësojë përhapjen dhe transmetimin e njohurive të nevojshme për të kuptuar dhe përpunuar

¹"Importance of education", Barr. G, April 2013

<http://www.thehindu.com/features/kids/importance-of-education/article4619651.ece>

²"The value of education", August, 2013

<http://www.globalpartnership.org/who-we-are/the-value-of-education/>

³"Education counts; Towards the millennium development goals", UNESCO, 2011,

<http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001902/190214e.pdf> f.6

⁴Ibid f.7

⁵Ibid f.8

informacionet e reja dhe për të zbatuar me sukses teknologjinë e re të hartuar nga të tjerët, të cilat përsëri promovojnë rritje ekonomike.⁶

Por, a ndikon më shumë ngritja e cilësisë së arsimit në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik në ngritjen e cilësisë në arsim? Nuk është e lehtë që të (i) jepet një përgjigje definitive për këtë. Të dy konstatimet kanë avantazhet dhe pikat e tyre të dobëta. Sipas pikëpamjes së parë, në mënyrë që një vend të ketë zhvillim ekonomik dhe shoqëror, bazë për ta duhet të jetë njeriu i arsimuar në institucione cilësore të arsimit. Sipas pikëpamjes së dytë, po që se nuk investohet në arsim atëherë edhe cilësia vështirë se do arrihet. Duhet të ketë paga më të larta për mësimdhënësit, fonde më të mëdha për analiza dhe hulumtime, investime në laboratore dhe teknologji informative në mënyrë që zhvillimi ekonomik të ngrisë cilësinë në arsim, e kjo mund të arrihet vetëm nëse buxheti shtetëror ka mjete të mjaftueshme për investime në arsim. Mbi të gjitha, arsimi cilësor mund të ndikojë më shumë në zhvillimin ekonomik se sa zhvillimi ekonomik në arsim cilësor. Sipas matjeve të Organizatës Europiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (OECD), janë vendet me cilësi të lartë të arsimit ato që po përjetojnë rritje ekonomike më të qëndrueshme.⁷

Një përparësi tjetër e madhe e arsimit është promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i pozitës së gruas, e kjo ka përparësitë e veta edhe në aspektin ekonomik. Pagat, të hyrat në agrikulturë dhe produktiviteti, që janë kryesore për ndalimin e varfërisë, janë më të larta nëse gratë që janë të përfshira në agrikulturë arsimohen më mirë.⁸ Në Amerikën Latine, fëmijët e nënave që kanë vijuar për disa kohë shkollën e mesme, mbesin në shkollë për dy deri në tre vite më shumë se sa fëmijët e nënave që kanë shkollim më të ulët.⁹ Niveli i vijueshmërisë së shkollës që përcillet nga gjenerata në gjeneratë paraqet një tregues për situatën e vendit në të ardhmen duke marrë për bazë situatën aktuale.

⁶ "The role of education in economic growth", Hanushek. A. E, Wobman, L., February 2007

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/7154/wps4122.pdf?sequence=1> f.20

⁷ "A ndikon ngritja e cilësisë së arsimit të lartë në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik ndikon në ngritje të arsimit të lartë?", Demokraci për zhvillim, Tetor 2011, <http://d4d-ks.org/editorialet/a-ndikon-ngritja-e-cilesise-se-arsimit-te-larte-ne-rritjen-e-zhvillimit-ekonomik-apo-zhvillimi-ekonomik-ndikon-ne-ngritje-te-arsimit-te-larte-2/>

⁸"Education counts; Towards the millennium development goals", UNESCO, 2011, <http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001902/190214e.pdf> f.12

⁹Ibid f.15

Shembujt e deritanishëm ishin më të përgjithshëm dhe të përmasave globale për të treguar se si faktorë të ndryshëm ndikojnë në rrjedhën e arsimit drejt zhvillimit ekonomik të një vendi.

Sido që të jetë, raporti në mes të rritjes ekonomike dhe edukimit ka qenë një ndër damarët kryesor të analizave të mëhershme ekonomike. Adam Smith në shekullin e XVIII dhe Alfred Marshall në shekullin e XIX, dy figura të rëndësishme në fushën e ekonomisë kanë parashtruar pyetjen se si investimi individual në arsimim ndikon në pasurinë e kombeve. Qasja e literaturës për këtë fenomen mund të ndahet në dy fusha të përgjithshme:

- a) Literatura mikroekonomike, që e shikon raportin në mes të mënyrave të ndryshme të matjes së arritjeve arsimore të një personi dhe se sa ata fitojnë. Shumica e studimeve tregojnë rezultate të përafërta për çka mund të quhet shpagim personal apo privat nga arsimi. Në mënyrë individuale kjo do të thotë se çdo vit shkollimi ngrit të ardhurat e tyre për 10%. Kjo është një shkallë e jashtëzakonshme e kthimit.
- b) Literatura makroekonomike e cila shikon raportin në mes të matjeve të ndryshme të nivelit total të arritjeve në fushën e edukimit për një vend si tërësi dhe në shumicën e rasteve matjen standarde të rritjes ekonomike në shprehje të GDP-së. Shumica e studimeve gjejnë fakte për rritje më të lartë të GDP-së në vende ku popullata mesatarisht ka kryer më shumë vite shkolle dhe ka arritur rezultate më të larta në testet e njohurive.¹⁰

Pa dyshim që Kosova nuk përbën rast përjashtues nga tezat e mësipërme. Në një ekonomi të re të cilën Kosova ka synim ta aplikojë, kapitali njerëzor konsiderohet si aset më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Kur themi kapital njerëzor kemi parasysh rolin e arsimit në ngritjen dhe formësimin e tij, duke ofruar kështu shkathtësitë kyçe që kërkohen në tregun e punës. Sa më i lartë që është niveli i arsimit aq më i lartë do të jetë niveli i të ardhurave. E gjithë kjo rezulton edhe me rritjen e probabilitetit për forcën punëtore të Kosovës për punësim jashtë vendit, që do të ndikonte në rritjen e remitançave për kokë banori në Kosovë. Shpenzimet në arsim duhet të shihen si investime, kthimet nga të cilat e përshpejtojnë rritjen ekonomike. E gjithë kjo shpie te konkludimi se Qeveria e Kosovës do të duhej ta ketë prioritet ndërtimin dhe

¹⁰ "Education and Economic Growth: From the 19th century to the 21st century", Miller. R, http://www.cisco.com/web/strategy/docs/education/eeg_what_research_says.pdf f.7

zhvillimin e sistemit arsimor në vend dhe si rrjedhojë kjo do të ndikojë edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.¹¹

Duke marrë parasysh të gjitha teoritë e shtjelluara dhe shembujt nga praktika e ditëve të sotme shihet qartë se arsimi ka rëndësi të madhe në formësimin e individit dhe shtetit si tërësi. Sa më shumë rëndësi e kujdes t'i kushtohet aq më pozitive do të jenë prurjet e tij.

¹¹“Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës”, Mustafa. I, Hoti. A, Gashi. P, Demukaj. V, Havolli. Y, Kotorri. M, Berisha. B, Berisha. A, Shkurt 2004, f.19

Bibliografia:

“Importance of education”, Barr. G, April 2013

<http://www.thehindu.com/features/kids/importance-of-education/article4619651.ece>

“The value of education”, August, 2013

<http://www.globalpartnership.org/who-we-are/the-value-of-education/>

“Education counts; Towards the millennium development goals”, UNESCO, 2011,

<http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001902/190214e.pdf>

“The role of education in economic growth”, Hanushek. A. E, Wobman, L., February 2007

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/7154/wps4122.pdf?sequence=1>

“A ndikon ngritja e cilësisë së arsimit të lartë në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik ndikon në ngritje të arsimit të lartë?”, Demokraci për zhvillim, Tetor 2011,

<http://d4d-ks.org/editorialet/a-ndikon-ngritja-e-cilesise-se-arsimit-te-larte-ne-rritjen-e-zhvillimit-ekonomik-apo-zhvillimi-ekonomik-ndikon-ne-ngritje-te-arsimit-te-larte-2/>

“Education and Ekonomik Growth: From the 19th century to the 21st century”, Miller. R,

http://www.cisco.com/web/strategy/docs/education/eeg_what_research_says.pdf

“Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës”, Mustafa. I, Hoti. A, Gashi. P, Demukaj. V, Havolli. Y, Kotorri. M, Berisha. B, Berisha. A, Shkurt 2004